



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT  
DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE**

Nr. 40 / prot.  
12

Tiranë më 12.03.2018

**VENDIM**

Nr. 12, datë 12.03.2018

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të Ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar, Ligjit nr. 44/2015 "*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*", procesverbalit të hetimit administrativ si dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit T.M.A. sh.p.k., Zyrë Përmbarimi Gjyqësor Privat me anëtar përmbaruesit gjyqësorë Alban Qazimi dhe Tedi Malaveci,

**KONSTATOVA SE:**

Në zbatim të Urdhrit nr.14 datë 10.01.2018 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim quajtur "Komisioneri"), për kryerjen e hetimit administrativ, duke filluar nga data 15.01.2018 e në vazhdim, grupi i inspektimit filloi procesin e hetimit administrativ me objekt:

- Zbatimi i Ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*" i ndryshuar dhe akteve të miratuara nga Komisioneri, në lidhje me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, gjatë kryerjes së aktivitetit të kontrolluesit Përmbarues Gjyqësorë Privat Alban Qazimi dhe Tedi Malaveci - "*T.M.A.*" sh.p.k.

Në funksion të Ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*" i ndryshuar, përmbaruesit gjyqësorë privatë konsiderohen si kontrollues, pavarësisht formës së organizimit të aktivitetit të tyre si *person juridik apo person fizik*. Në cilësinë e kontrolluesit, ata mbledhin dhe përpunojnë të dhëna personale për kategoritë "*punonjës*", "*vizitorë*", "*debitorë-kreditorë*" etj.

Në zbatim të Urdhrit nr.14 datë 10.01.2018 të Komisionerit, me datë 15.01.2018, grupi i kontrollit u paraqit pranë shoqërisë përmbarimore T.M.A. sh.p.k.

Përfaqësuesi i kontrolluesit, Z. Tedi Malaveci nuk pranoi që të kryhej inspektimi me pretendimin se me shkresën nr. 22 prot. datë 12.01.2018, është njoftuar Zyra e Komisionerit për pamundësinë e kontrolluesit për të pritur grupin e inspektimit për arsye se dy përmbaruesit ishin të angazhuar profesionalisht jashtë zyrave të shoqërisë, duke kërkuar në këtë mënyrë shtyrjen e datës të inspektimit pas datës 14.02.2018.

Zyra e Komisionerit, duke marrë në konsideratë kërkesën e kontrolluesit T.M.A. shpk, me shkresën nr. 40/3 prot. datë 23.01.2018, i bën me dije kontrolluesit se inspektimi do të kryhet pranë zyrës së tyre, me adresë Bulevardi "Gjergj Fishta", Kulla nr. 5, nr. 17, Tiranë, me datë 15.02.2018 ora 10:00.

Me datë 15.02.2018 ora 10:00, grupi i kontrollit u paraqit pranë zyrës së kontrolluesit T.M.A. shpk, për zbatimin e Urdhrit nr. 14 datë 10.01.2018 të Komisionerit si dhe shkresës nr. 40/3 prot. datë 23.01.2018.

Grupi i kontrollit sërish nuk u lejua të kryente hetimin administrativ për arsye se një nga punonjëset e kontrolluesit u shpreh se përfaqësuesit e T.M.A. shpk, nuk janë të disponueshëm për këtë qëllim. Për këtë rast grupi i kontrollit hartoi procesverbalin përkatës i cili u nënshkrua nga inspektorët e Zyrës së Komisionerit.

Me shkresën nr. 40/4 prot. datë 21.02.2018, Zyra e Komisionerit bëri sërish me dije kontrolluesin T.M.A. shpk se kontrolli administrativ do të vijojë në datën 26.02.2018 ora 10:00. Në këtë shkresë iu kërkua kontrolluesit të merren masa për sigurimin e kushteve të punës dhe vënien në dispozicion të një përfaqësuesi të T.M.A. shpk për të përmbushur detyrimet sipas nenit 32 të Ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*", i ndryshuar.

Sipas shkresës së sipërpërmendur, me datë 26.02.2018 ora 09:58, inspektorët e Zyrës së Komisionerit u paraqitën pranë ambienteve të kontrolluesit T.M.A. shpk., ku u pritën nga një punonjëse e cila i bëri me dije grupit të kontrollit se me datë 23.02.2018, T.M.A. shpk ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit shkresën nr. 136 prot. me lëndë: "*Informim dhe përgjigje për shkresën nr. 40/4 prot., datë 21.02.2018 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale*", një kopje të së cilës ia dorëzoi dhe inspektorëve. Punonjësja bëri me dije inspektorët se, në mungesë të përfaqësuesit ligjor të T.M.A. shpk, ata nuk mund të ushtronin kontroll.

Administratori i kontrolluesit T.M.A. shpk, Z. Tedi Malaveci, komunikoi nëpërmjet telefonit me inspektorët e Zyrës së Komisionerit duke iu përmendur shkresën e depozituar pranë kësaj zyre. Ai iu kërkoi inspektorëve të largohen nga ambientet e kontrolluesit në mënyrë të menjëhershme duke shtuar se Zyra e Komisionerit mund të kërkojë bashkëpunim, por nuk mund të ushtrojë kontroll kryesisht.

Inspektorët i bënë me dije administratorit të kontrolluesit, Z. Malaveci se janë paraqitur pranë ambienteve të T.M.A. shpk për të ushtruar hetimin administrativ, në kushtet kur T.M.A. shpk është informuar në vijnësi për orën dhe datën e ushtrimit të këtij kontrolli. Z. Malaveci, ripërsëriti kërkesën e tij për t'u larguar nga zyrat e T.M.A. shpk dhe kthimin e një përgjigje institucionale në lidhje me shkresën me lëndë: "*Informim dhe përgjigje për shkresën nr. 40/4 prot., datë 21.02.2018 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale*", të depozituar pranë Zyrës së Komisionerit, duke kërkuar bashkëpunim dhe jo kontroll. Të ndodhur në këto kushte, grupi i kontrollit u largua nga zyrat e kontrolluesit T.M.A. shpk.

Mbi rrethanat e këtij fakti u mbajt një procesverbal në Zyrën e Komisionerit dhe nga verifikimi në protokollin e kësaj të fundit, rezultoi se shkresa nr. 136 prot., datë 23.02.2018 me lëndë: "*Informim dhe përgjigje për shkresën nr.40/4 prot., datë*



21.02.2018 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, ishte depozituar në mëngjesin e datës 26.02.2018 dhe jo me datë 23.02.2018 sikundër pretendonte kontrolluesi T.M.A. shpk.

Zyra e Komisionerit, në përmbushje të detyrimit për vijimin e procesit si dhe duke marrë në konsideratë angazhimet e pretenduara nga përfaqësuesit e T.M.A. shpk, nëpërmjet shkresës nr. 40/6 prot. datë 27.02.2018, propozoi katër data të mundshme për ushtrimin e hetimit administrativ. Nisur nga fakti që statusi juridik i kontrolluesit është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (T.M.A. shpk), Zyra e Komisionerit ka sqaruar në këtë shkresë se, në pamundësi të pjesëmarrjes fizike të titullarëve të T.M.A shpk, mund të caktohet një person përgjegjës për përmbushjen e detyrimeve që burojnë nga ligji.

Me shkresën nr. 154 prot. datë 27.02.2018, kontrolluesi T.M.A. shpk ka shprehur paqartësi lidhur me faktin nëse hetimi administrativ do të ushtrohet ndaj shoqërisë apo ndaj dy përmbauesve gjyqësorë privatë, ortakë të kësaj shoqërie.

Me shkresën nr. 40/8 prot. datë 01.03.2018 drejtuar T.M.A. shpk, Zyra e Komisionerit ka sqaruar se Urdhri nr. 14 datë 10.01.2018 si dhe çdo akt tjetër që lidhet me të, është mbështetur në të dhënat e pasqyruara në ekstraktin historik të QKB-së për subjektin në fjalë. Gjithashtu, në vijim të frymës së bashkëpunimit të sanksionuar në nenin 32 të Ligjit nr. 9887/2008 “Për Mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, kontrolluesi T.M.A. shpk duhet të njoftojë Zyrën e Komisionerit jo më vonë se data 06.03.2018, për disponibilitetin në një nga datat e propozuara me shkresën nr. 40/6 datë 27.02.2018 të Komisionerit.

Me datë 06.03.2018 ora 13:00, inspektorët e Zyrës së Komisionerit janë paraqitur sërish në ambientet e kontrolluesit T.M.A. shpk ku është ripërsëritur situata e datës 26.02.2018 ku ata janë pritur nga një prej punonjëseve të T.M.A. shpk, e cila iu bëri me dije se përfaqësuesit e kontrolluesit nuk ishin të pranishëm dhe në mungesë të tyre, inspektorët nuk mund të ushtronin kontroll.

Ndonëse me subjektin është mbajtur një korrespondencë e gjatë, sërish nuk është bërë e mundur që të kryhet kontroll administrativ.

Në zbatim të së drejtës për t’u dëgjuar, e sanksionuar në nenet 87-89 të Ligjit nr. 44/2015 datë 30.04.2015 “Kodi i Proçedurës Administrative”, kontrolluesi T.M.A. shpk është njoftuar të marrë pjesë në seancë dëgjimore në ambjentet e Zyrës së Komisionerit në datën 09.03.2018 ora 12:00.

Nëpërmjet shkresës nr. 174 prot. datë 07.03.2018, kontrolluesi T.M.A. shpk ka njoftuar se nuk do të marrë pjesë në seancën dëgjimore të organizuar nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale duke pretenduar sipas tyre edhe kthimin e këtij procesi në rrugën e ligjshmërisë.

Në analizë përfundimtare të të gjithë kësaj praktike, referuar të gjitha provave shkresore të vendosura në dosje, Zyra e Komisionerit konstaton se:

- Në planin vjetor (faqe 7) të miratuar nga Komisioneri për periudhën Janar-Mars 2018, është parashikuar një fushatë kontrolli administrativ pranë subjekteve që ushtrojnë verpimtarinë në fushën e përmbaimit gjyqësor privat dhe shtetëror.



- Përmbaruesit Gjyqësorë Privatë janë kontrollues, pavarësisht formës së organizimit të aktivitetit të tyre *si person juridik apo person fizik*. Referuar nenit 3, pika 5 e Ligjit nr. 9887/2008 *“Për Mbrojtjen e të dhënave Personale”*, i ndryshuar:
  - *“Kontrollues”* është çdo person fizik ose juridik, autoritet publik, agjenci apo ndonjë organ tjetër që, vetëm apo së bashku me të tjerë, përcakton qëllimet dhe mënyrat e përpunimit të të dhënave personale, në përputhje me ligjet dhe aktet nënligjore të fushës, dhe përgjigjet për pëmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj.

Në cilësinë e kontrolluesve, ata mbledhin dhe përpunojnë të dhëna personale për kategoritë për të cilët është marrë vendim ekzekutimi. Referuar nenit 3 përkatësisht pika 1 dhe 6 të Ligjit nr. 9887/2008 *“Për Mbrojtjen e të dhënave Personale”* i ndryshuar:

- *“Të dhëna personale”* është çdo informacion në lidhje me një person fizik, të identifikuar ose të identifikueshëm, direkt ose indirekt, në veçanti duke iu referuar një numri identifikimi ose një a më shumë faktorëve të veçantë për identitetin e tij fizik, fiziologjik, mendor, ekonomik, kulturor apo social.
- *“Subjekt i të dhënave personale”* është çdo person fizik, të cilit i përpunohen të dhënat personale.

Referuar përcaktimeve të mësipërme si dhe formës së ushtrimit të aktivitetit, T.M.A. shpk, merr cilësinë e *“Kontrolluesit”* dhe për rrjedhojë, është subjekt i detyrimeve që burojnë nga Ligji nr. 9887/2008 *“Për mbrojtjen e të dhënave personale”*, i ndryshuar.

Neni 29 i ligjit, pika 1 parashikon kompetencat e Komisionerit sipas të cilit: *“Komisioneri për mbrojtjen e të dhënave personale dhe të drejtën e informimit është autoriteti përgjegjës i pavarur, që mbikëqyr dhe monitoron, në përputhje me ligjin, mbrojtjen e të dhënave personale, duke respektuar e garantuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut.”*

Zyra e Komisionerit është institucioni i pavarur, autoriteti mbikëqyrës dhe garant për zbatimin e Ligjit nr. 9887/2008 *“Për Mbrojtjen e të dhënave Personale”*, i ndryshuar.

Pavarësisht faktit se Zyra e Komisionerit ka treguar mirëkuptim ndaj kërkesave të kontrolluesit brenda afateve ligjore, hetimi administrativ nuk është realizuar sepse subjekti T.M.A. shpk i është shmangur vazhdimisht kontrollit. Shmangia e kontrollit konsiderohet mungesë bashkëpunimi referuar nenit 32 të Ligjit nr. 9887/2008 *“Për Mbrojtjen e të dhënave Personale”* i ndryshuar sipas të cilit:

1. *“Institucionet publike dhe private bashkëpunojnë me komisionerin, duke i siguruar të gjithë informacionin që ai kërkon për pëmbushjen e detyrave, si dhe e njëjtojnë atë për zbatimin e rekomandimeve të dhëna menjëherë pas mbarimit të afatit të caktuar për kryerjen e tyre.”;*
2. *Komisioneri ka akses në sistemin e kompjuterave, në sistemet e arkivimit, që kryejnë përpunimin e të dhënave personale dhe në të gjithë dokumentacionin, që lidhet me përpunimin dhe transferimin e tyre, për ushtrimin e të drejtave dhe të detyrave që i janë ngarkuar me ligj.”*

Zyra e Komisionerit konkludon se mungesa e bashkëpunimit përbën shkelje administrative sipas nenin 39/1 "dh/1" të ligjit i cili përcakton se: "kontrolluesit dhe përpunuesit, që veprojnë në kundërshtim me pikën 2 të nenit 32 të këtij ligji, dënohen me 100.000 deri në 1.000.000 lekë."

Nga verifikimi në protokollin e Zyrës së Komisionerit dhe regjistrin elektronik të subjekteve kontrolluese të cilin e administron Zyra e Komisionerit, është konstatuar ndër të tjera se kontrolluesi T.M.A. shpk nuk ka përmbushur detyrimin për të njoftuar në lidhje me përpunimin e të dhënave personale në zbatim të neneve 21 dhe 22 të ligjit.

Kontrolluesi T.M.A. shpk, në formën ligjore të aktivitetit të vet tregtar, është person juridik dhe sipas nenit 39/2 të Ligjit Nr. 9887/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar, dënohet me dyfishin e gjobës të përcaktuar më sipër.

Në përzgjedhjen e sanksionit që do të zbatohet në rastin konkret Zyra e Komisionerit mban parasysh qëndrimin e treguar në mënyrë të vazhdueshme nga ana e subjektit T.M.A. Shpk, ku pavarësisht qasjes konstruktive të treguar nga ana e Zyrës së Komisionerit, subjekti në fjalë ka refuzuar në mënyrë të vazhdueshme t'i nënshtrohet kontrollit administrativ.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Në zbatim të neneve 21, 29, 30, 32 dhe Kreu II, neni 39 pika 1, gërma "dh/1", si dhe nenit 39, pika 2 e Ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar,

### **V E N D O S A:**

1. Dënimin e kontrolluesit "T.M.A. shpk" sh.p.k. Tiranë, me gjobë në vlerën **500.000 (pesëqindmijë) lekë** për shkelje të detyrimeve të përcaktuara në nenin 32/2 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar.
2. Gjoha në masën 500.000 (pesëqindmijë) lekë të arkëtohet nga kundërvajtësi në Buxhetin e Shtetit, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga komunikimi i këtij vendimi. Me kalimin e afatit të ankimit, ky vendim kthehet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga zyra e përmbartimit.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga komunikimi i këtij Vendimi.

Ky vendim u shpall sot, më 11.03.2018.

**KOMISIONERI**

**Besnik Dervishi**







REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT  
DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE  
DREJTORIA E HETIMIT ADMINISTRATIV**

Nr. 40/15 prot.

Tiranë më 12.4.2018

**VENDIM**

Nr. 12/1, datë 12.4.2018

**PËR**

**SHFUQIZIMIN E AKTIT ADMINISTRATIV**

Në mbështetje të neneve 130 – 140 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Proçedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”,

**KONSTATOVA SE:**

Me shkresën nr. 265, datë 04.04.2018 kontrolluesi T.M.A. shpk i është drejtuar Zyrës së Komisionerit duke paraqitur kërkesën për anulimin apo shfuqizimin e aktit administrativ, vendimit nr. 12, datë 12.03.2018 të Komisionerit.

Edhe pse jo në formën e kërkuar, konstatohet se kemi të bëjmë me një ankim administrativ ndaj aktit administrativ të parashikuar nga nenet 130 - 133 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Proçedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”.

Në vlerësim të përmbajtjes së kërkesës, konstatohet angazhimi i kontrolluesit për respektimin e detyrimeve që burojnë nga zbatimi i ligjit nr. 9887/2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar.

Objekti i punës dhe veprimtarisë së Zyrës së Komisionerit në mbikqyrjen sektoriale, si në rastin e shërbimit përmbarimor, konsiston në ndërgjegjësimin e tyre në cilësinë e kontrolluesit dhe jo të vendosjes së sanksioneve administrative ndaj tyre.

Për këtë arsye, duke vlerësuar të realizuar qëllimin e hetimit administrativ sektorial ndaj shërbimit përmbarimor dhe në rastin konkret edhe ndaj kontrolluesit, shoqërisë T.M.A. shpk, Komisioneri vlerëson se ekzistojnë kushtet për shfuqizimin e aktit administrativ.

Kontrolluesi T.M.A. shpk duhet të zbatojë rekomandimet unifikuese të Komisionerit të cilat i dërgohen Ministrisë së Drejtësisë dhe Dhomës Kombëtare të Përmbaruesve

Gjyqësorë Privatë, të cilat synojnë standartizimin në zbatimin e detyrime që burojnë nga ligji 9887/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar, me qëllim final garantimin e të drejtës kushtetuese të mbrojtjes së të dhënave personale të shtetasve të sanksionuar në nenin 35 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

### PËR KËTO ARSYE

Bazuar në nenin 136 të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Proçedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë",

### V E N D O S A:

1. Pranimin e ankimit dhe shfuqizimin e aktit administrativ, vendimit nr. 12, datë 12.03.2018 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
2. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë brenda 45 ditëve nga marja dijeni.
3. Ky vendim u shpall sot në datë 12.4.2018.

**KOMISIONERI**

**Besnik Dervishi**

